

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarit I.R., nga fsh. Sh., komuna e P., për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë, nga neni 302 par.2 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit av. B.S., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.216/2017 të datës 22.02.2018, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.148/2018 të datës 27.04.2018 në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 01.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit I.R., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.216/2017 datë 22.02.2018, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.148/2018 datë 27.04.2018.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.216/2017 të datës 22.02.2018, të dënuarin I.R. e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK, dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti të cilin do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Është obliguar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 euro, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit si dhe ti kompensoi shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të gjykatës. Në pajtim me nenin 69 dhe 302 par.3 të KPRK, ndaj të dënuarit është shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimi i sendeve, ashtu që nga i dënuari janë konfiskuar 24 bankënota me vlerë prej 50 € me nr. serik sikurse në vërtetimin për konfiskimin e sendeve me shenjë 2016-AB-2353.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.148/2018 të datës 27.04.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të dënuarit dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve në afatin ligjor, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit av. B.S. nga Podujeva për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës në Prishtinë, ta aprovojë

kërkesën dhe ta ndryshojë vendimin e formës së prerë në favor të dënuarit, ose ti anuloi vendimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.II.nr.165/2018 të datës 21.09.2018, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

Kërkesa e mbrojtësit të dënuarit për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit pretendon që aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase aktgjykimi është i paqartë, konfuz dhe kundërthënës me vet veten, ngase në faqen 2 par 2 të arsytimit konstatohet “ në asnjë fazë të procedurës penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor i dënuari nuk e ka pranuar fajësinë” pastaj në faqen 5 par 2 konstatohet se për të dënuarin gjykata si rrethanë lehtësuese konsideroi pranimin e fajësisë” si dhe kundërthënie të njëjta gjen edhe në faqen 2 par 3 ku thuhet” gjatë shqyrtimit gjyqësor i mundësoi të dënuarit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të dënuarit, mirëpo nga shikimi i shkresave në lëndë e sidomos nga shikimi i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se i dënuari I.R. nuk e ka pranuar fajësinë, nuk ka pasur mbrojtës si dhe të njëjtit nuk i është ofruar asgjë nga shkresat e lëndës, prandaj i dënuari nuk ka pasur mundësi që ti shfrytëzoj të drejtat e tij procedurale konform dispozitave ligjore. Po ashtu i tërë arsytimi i aktgjykimi bazohet në deklaratat e dëshmitarit E.Sh., dhe ekspertizës përkitazi me falsifikimin e kartëmonedhave , prova këto të gjitha në kundërshtim njëra me tjetrën nga të cilat edhe ashtu nuk vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më detajisht në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar. Po ashtu në kërkesë pretendohet se dëshmia e dëshmitarit E.Sh. është provë e papranueshme, ngase e njëjta është kundërthënëse dhe atë përveç me vet veten edhe me provat e tjera e sidomos me ekspertizën në shkresat e lëndës, ekspertizë kjo në të cilën konstatohet se bëhet fjalë për falsifikim të pjesshëm, prandaj të gjitha këto janë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve të paraqitura në kërkesë, gjen se ato janë të pabazuara, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, i njëjti nuk ka asgjë konfuz dhe se në përmbajtjen e tij janë paraqitur të gjitha veprimet inkrimuese të të dënuarit e që përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor. Po ashtu në arsytimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare, duke u bazuar së pari në vet deklaratën e të dënuarit. Pretendimi i mbrojtësit lidhur me atë se gjykata në arsytimin e aktgjykimit ka konstatuar se i dënuari në të gjitha fazat e procedurës nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa me rastin e matjes së dënimit gjykata si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë është në kundërshtim me veten, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate del të jetë i pabazuar ngase me shikimin e shkresave të lëndës dhe arsytimit të aktgjykimit të kundërshtuar rezulton se gjykata ka administruar prova dhe në bazë të provave të administruara ka vërtetuar fajësinë e të

dënuarit , që nuk është kundërthënëse sepse i dënuari nuk e ka pranuar fajësinë, ndërsa vlerësimi i pranimit të fajësisë si një prej rrethanave lehtësuese aktgjykimin nuk e bënë të paqartë. Ai nuk i ka mohuar faktet dhe rrethanat se pasi më parë kishte marrë kartelën bankare nga dëshmitari Enis Shabani, përmes së njëjtës ka futur në bankomatën e bankës “Raiffaisen” bankënotat në shumën prej nga 50 €, gjithsejtë 1,200 € në llogarinë e dëshmitarit E.Sh., të cilat bankënota nga bankomati janë veçuar menjëherë në vendin e paraparë për para të dyshimta, fakte këto që janë vërtetuar po ashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit E.Sh., pastaj ekspertiza e agjencisë për forenzikë-sektori për ekspertimin e dokumenteve dhe dorëshkrimeve, ku është vërtetuar se bankënotat në fjalë janë të falsifikuara.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, duke konstatuar gjendjen faktike të vërtetuar si në dispozitiv të aktgjyimit të ankimuar, kuptohet pra, duke u bazuar në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe gjatë paraqitjes së arsyerave për faktet vendimtare në arsyetim nuk ka paqartësi dhe konfuzitet, sikur që pretendohet në kërkesë. Po ashtu aktgjykimi, nuk bazohet në prova të pa pranueshme siç pretendohet, ngase, deklarata e dëshmitarit E.Sh. është marrë në përputhshmëri të plotë me dispozitat procedurale të parapara për marrjen në pyetje sipas KPPK, duke përfshirë procedurën paraprake por edhe shqyrtimin gjyqësor. Po ashtu edhe me ekspertizën e Agjencisë për forenzikë- sektori për ekspertimin e Dokumenteve të dorëshkrimeve, me pa mëdyshje vërtetohet se bëhet fjalë për bankënota të falsifikuara.

Lidhur me pretendimin në kërkesë përkitazi me angazhimin e mbrojtësit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate ky pretendim është i pabazuar, ngase në bazë të shkresave të lëndës, vërtetohet se i dënuari qysh në fazën paraprake është njoftuar për të drejtat e tij që i takojnë sipas ligjit, duke përfshirë edhe të drejtën e mbrojtjes , mirëpo i njëjti ka hequr dorë nga e drejta në mbrojtës duke nënshkruar edhe personalisht, procesverbalin prandaj nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në këtë drejtim, sikurse që pretendohet në kërkesë.

Vlen të theksohet se konkludimet e të dy gjykatave lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor janë rezultat i vlerësimit drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor kështu që asnjë fakt nuk ka ngjelur dubioz ose i pavërtetuar dhe si rrjedhojë, drejt është aplikuar ligji penal.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit, andaj kërkesa e të dënuarit është refuzuar si e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Më 01.10.2018 Pml.nr.241/2018

Procesmbajtëse,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa